

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/pese-muaj-pa-te-birin-nena-kerkon-zbatimin-e-vendimit-te-gjy-kates-i514917
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 20:24:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 20:18:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a5d15ca73f2c9662f0a5b9a68a6d146ea72273a94b1cae0c1f2c70b6d0edbe5
TEKSTI	2688f7527ce7ed0ee8ca08a3f0a8eb7994998a47b8e2afb59262353fd3652df2
PAMJA	751378d68f540aaa60fa20366189c0f7b12926d67d5de461f8d417a5e78b9403

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	13b805dfc59717037551ee11c1c199e788b556eefb902937a964f885e1202ec3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d8fd0ed91dbebc864780a4583f7f7de5df5b250232dc1d3996dcf03dc7a10c89
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/13b805dfc59717037551ee11c1c199e788b556eefb902937a964f885e1202ec3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

2 ORE ME PARE

111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

10 ORE ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

12 ORE ME PARE

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkojë rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

1 DITE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

Aktualitet

Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës

I tillë është edhe rasti i Zojë Martinit, të cilës ish-partneri i mohon të drejtën për të takuar djalin 7-vjeçar. Ajo thotë se nga viti 2015 ka bashkëjetuar me shtetasin Pëllumb Bicuku dhe nga kjo bashkëjetesë, për katër vite, ka ardhur në jetë një fëmijë.

dosja

18 Shtator 2026, 22:18
Nga E. D



TIRANË- Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasin drejtpërdrejt të vegjëlit, ndërkohë që hakmarrja e verbër e ish-it bëhet pengesë për një raport normal të fëmijës me prindin tjetër. I tillë është edhe rasti i Zojë Martinit, të cilës ish-partneri i mohon të drejtën për të takuar djalin 7-vjeçar.

Ajo thotë se nga viti 2015 ka bashkëjetuar me shtetasin Pëllumb Bicuku dhe nga kjo bashkëjetesë, për katër vite, ka ardhur në jetë një fëmijë.

"Kur kam nisur bashkëjetesën me të, kam qenë 21 vjeçe. Zotëria ka qenë më i madh se unë. Nga kjo bashkëjetesë ka pasur gjithmonë konflikte, ka pasur gjithmonë debate, ka pasur edhe dhunë psikologjike dhe fizike".

E re dhe me ëndrra të ndërprera në mes, jeta e Zojës do të merrte një drejtim që as nuk e kishte imagjinuar ndonjëherë. Një vajzë, të cilës në atë kohë i kishin prezantuar dikë me të cilin do të lidhte jetën, por që, në vend të lumturisë, për vite me radhë do të përjetonte dhunë të vazhdueshme dhe frikën për të denoncuar, shoqëruar kjo edhe me indiferencën e atyre që e rethonin.

Zoja tregon se asnjëherë nuk ka pasur përkrahjen e familjes së tij, përkundrazi, edhe ata kanë pasur gjithmonë debate dhe ngatërresa, konflikte. Me këto situata aspak normale dhe të paqarta, do të kalonin tre vite, gjatë të cilave vajza do të bënte kapërcimin nga adoleshenca në moshë madhore, ndryshim që pak nga pak do t'ia ndryshonte idetë e asaj bashkëjetese të sforcuar, por pikërisht në momentet kur mendonte seriozisht ndarjen, mori vesh që ishte shtatzënë.

Pavarësisht ftohtësisë së partnerit ndaj një lajmi që supozohet se do ta lumturonte, Zoja kishte një motiv shumë të madh për të harruar, të paktën momentalisht, problemet e shumta të jetesës në shtëpinë e Pëllumbit dhe

editoriale

Irena Begiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 18 SHTATOR 2026, 17:07

Doli nga qelia dhe shkoi në
spitalin Salus/ Veliaj kishte
thyer këmbën duke luajtur
futboll në paraburgim, sot
shkoi për të bërë grafinë

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 20:00

FOTO/ Aksidenti në Athinë,
këta janë tre të rinjtë që
humbën jetën tragjikisht

tamijareve te tij. Por ky entuziazem per temijen qe do te vinte ne jete do te zdonej snume snejt nga sjeija e partnerit.

I cili ka ushtruar edhe dhune ndaj saj ne momentin e shtatzenise.

Aq me tepër qe nuk kishte asnjë person tek i cili të mbështetej në atë periudhë të vështirë. Sepse familja e saj ndodhej larg.

Por, pavarësisht kësaj zgjedhjeje të Zojës për ta mbajtur larg familjen e saj nga çdo situatë që po kalonte, në muajin e nëntë të shtatzënisë do të ndodhte diçka që do të thellonte edhe më shumë hendekun me bashkëjetuesin. Pasi vëllai i saj kishte ardhur nga Italia dhe ka kërkuar ta takojë të motrën, por ish-bashkëjetuesi nuk e ka lejuar, duke iu përgjigjur shumë agresiv në telefonatë.

Por edhe pse kishte përjetuar konflikte dhe dhunë, ndarja nuk ishte një vendim i lehtë për të, sepse fakti që ishte shtatzënë në muajin e fundit dhe ideja se lindja e fëmijës mund t'i afronte, ndikoi në marrjen e një vendimi të gabuar për t'u kthyer sërish me Pëllumbin.

Ishte Zoja ajo që e kërkoi rikthimin. E kontaktoi dhe i propozoi të flisnin, t'i jepnin një mundësi të dytë marrëdhënies së tyre dhe të rrisnin së bashku djalin që po vinte në jetë.

Ndërkohë, familja e saj nuk e priti aspak mirë rikthimin me dhunuesin në muajin e nëntë të shtatzënisë. Por, pak nga pak, dita që ajo e kishte pritur për nëntë muaj kishte ardhur. Babai i fëmijës, sipas Zojës, ishte aty afër, por prania e tij në atë moment ishte më shumë fizike sesa emocionale.

Tre muajt e parë të jetës së fëmijës, në vend që të ishin një periudhë afrimi mes babait dhe të voglit, do të shoqëroheshin me një distancë të pakuptueshme, ndërkohë që marrëdhënia mes çiftit sa vinte e përkeqësohej. Ajo thotë se, prapë, edhe pasi erdhi djali në jetë, "që unë shpresova, mendova që do të kthehet si person", ka pasur prapë konflikte, prapë ngatërresa, ka pasur edhe prapë dhunë fizike.

Deri në momentin që ka thirrur edhe policinë në telefon, por gjithmonë ka pasur atë frikën edhe ndrydhen e tij, sepse e ka pasur përballë aty kur policia ka ardhur te shtëpia. Frikë që e ka bërë Zojën të mos e ndiqte më tej denoncimin, duke u detyruar që për një kohë të gjatë të mos raportonte asnjë sjellje agresive të partnerit. Me djalin pesë muajsh në krahë, nëna e re shkoi në komisariat. Për herë të parë, vendosi të fliste dhe të tregonte atë që kishte ndodhur.

Dhe aty mori vendimin që të largohej një herë e mirë nga bashkëjetesa, bashkë me të voglin e saj, për të shkuar kështu te të afërmit e saj. Ndërkohë, babai i fëmijës nuk interesohet fare dhe, duke parë këtë situatë dhe mosinteresimin e tij, ajo merr vendimin që, në mënyrë të jashtëligjshme, të ikë drejt Italisë.

Por pikërisht kur Zoja mendonte se i kishte lënë pas hijet e së shkuarës, në Itali mbërriti një denoncim nga ish-partneri.

Sipas Zojës, ish-partneri kishte bërë gjithçka në heshtje, duke vënë në lëvizje drejtësinë në Shqipëri, ndërkohë që ajo vetë nuk dinte asgjë se çfarë po ndodhte.

Një vendim që do të ndryshonte rrjedhën e jetës, jo vetëm të nënës, por edhe të fëmijës, asokohe 5-vjeçar. Pas kthimit nga Italia, nisën takimet e përcaktuara nga gjykata mes fëmijës dhe babait. Por, sipas Zojës, djali nuk e njihje të atin dhe takimet zhvilloheshin në prani të psikologes. Por ajo që duhej të ishte një seri takimesh njohjeje mes babait dhe djalit, do të përfundonte ndryshe nga sa ishte planifikuar. Sepse fëmija u mor fshehurazi nënës.

Pavarësisht rrethanave skandaloze se si ky grup personash kanë bashkëpunuar për t'i marrë fëmijën 5-vjeçar një nënë, duhet theksuar se policia i kishte duart e lidhura nga vendimi i gjykatës, prandaj çdo urë komunikimi e mëpasshme duhej të kalonte përmes ish-partnerit. Në një situatë kur të gjitha dyert i mbyllën në fytyrë, beteja e Zojës zhvendoset në dyert e gjykatave. Aty ku, në fakt, duhej të niste që pa shkuar në Itali.

Në një raport psikologjik të mbajtur nga Valbona Treska thuhet se fëmija duhet të qëndrojë me nënën, pasi ka një atashim të thellë me nënën e tij. Por vendimi i Shkallës së Parë nuk do të ishte fundi. Babai apeloj dhe çështja do të vijonte për vite nëpër shkallët e gjyqësorit.

Deri kur, më 5 mars 2026, Gjykata e Apelit Tiranë merr vendimin që kujdestaria e fëmijës t'i kalojë nënës, por që nga marsi i vitit 2026, Pëllumbi ka ndërprerë çdo kontakt me ish-partneren, duke e penguar atë që të shohë djalin, qoftë edhe për pak minuta./Piranjat news

POLITIKE 18 SHTATOR 2026, 19:20

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Christopher Hill: Thaçi nuk ka qenë i përfshirë në vepra të paligjshme

më të klikuarat

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj del nga qelia, kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamentit Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditë Latinopoulou

Pagat e magistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreve pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...

Takimi sekret në Buenos Aires/ Mediat urugaiane: DEA paralajmëron përparimin e mafies shqiptare në rajon

insights

Auron Janku Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:57

Mbyllet protesta e 111-të, qytetarët thirrje: Nesër më shumë

Pamje nga marshimi TIRANË- Qytetarët kanë mbyllur protestën e 111-të kundër qeverisë, ndërsa kanë kë...

Liria nuk burgoset, as në Hagë, as në Beograd

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:57

"Ministrja kopjace"/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:56

"Nuk duam të ikim nga Shqipëria, por nga ju"/ Monologu i një brezi që nuk ju ka frikë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:54

"Jo në emrin tim"/ Qytetarët sërish në protestë kundër vendimit të Speciales, mijëra pjesëmarrës në Prishtinë, mes protestuesve edhe djali i Thaçit e Veselit (PAMJET)

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:25

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:22

Flamingot që “zgjuan” një popull kundër qeverisë/ Revolta më e madhe qytetare në 30 vite

TIRANË- Ishte data 30 maj, ku një qytetar u tërhoq zvarrë nga rojet private në Zvërnec të Vlorës. Ishte pikërisht...

"Vendi ynë më i rëndësishëm se gjithçka"/ Aktivisti Arben Kola thirrje të rinjve: Të bëhemi bashkë, të shpëtojmë Shqipërinë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:00

Nga dorëheqja e Ramës, te shfuqizimin i ligjit për investimet strategjike, aktivistja rendit kërkesat e protestuesve

Aktualitet

18 Shtator 2026, 20:57

Edison Lika thirrje qytetarëve: Reagoni ndaj padrejtësive! Ky regjim nuk rrëzohet me dy ditë protestë por me njerëz që rezistojnë deri në fund

Aktualitet


18 Shtator 2026, 20:34

Dita e 111-të e protestës/ Mbyllen fjalimet, nis marshimi i qytetarëve në rrugët e Tiranës

Aktualitet


18 Shtator 2026, 20:51

MË SHUMË



dosja

Prishtinë



Prishtina proteston për vendimin e Hagës, djali i Thaçit e Veselit mes protestuesve



Prishtina proteston për vendimin e Hagës, djali i Thaçit e Veselit mes protestuesve



Dita e 111-të e protestës/
Mbyllen fjalimet, nis
marshimi i qytetarëve në
rrugët e Tiranës



Protesta në Tiranë/ Nis
marshimi drejt
Kryeministrit, thirrje: Jepe
dorëheqjen



Rama: Euro e dobët, duhet
reflektim te çmimet

Prishtina proteston për vendimin e Hagës, djali i Thaçit e Veselit mes protestuesve

 Shiko video te tjera

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.